



# Fëmija juaj ka nevojë për mbrojtje : çfarë ndodh ?



DJES Département de la jeunesse, de  
l'environnement et de la sécurité  
DGEJ Direction générale de  
l'enfance et de la jeunesse

# Ne duhet t'i mbrojmë fëmijët



Ndërhyrja e Drejtorisë së përgjithshme të fëmijërisë dhe rinisë (Direction générale de l'enfance et de la jeunesse - DGEJ) pranë familjes suaj është diçka e re për ju. Ju keni pyetje e ndjeni frikë, çka është krejt normale.

Kjo broshurë ju shpjegon se çka bëjnë DGEJ-ja dhe Autoriteti i mbrojtjes së fëmijës (Autorité de protection de l'enfant - APE). Ajo ju shpjegon gjithashtu të drejtat dhe detyrat tuaja si prindër.

## Çfarë është Drejtoria e përgjithshme e fëmijërisë dhe rinisë (Direction générale de l'enfance et de la jeunesse - DGEJ)?

DGEJ-ja është një shërbim i Shtetit të Vaudit. Ajo është e ngarkuar të sigurojë bashkë me prindërit, ose pas një vendimi të Autoritetit të mbrojtjes së fëmijës (Autorité de protection de l'enfant - APE), mbrojtjen e të miturve në rrezik gjatë zhvillimit të tyre. DGEJ-ja është e ngarkuar edhe me misione të tjera: si për shembull nxitja e pjesëmarrjes së të rinjve si dhe parandalimi në mjedisin shkollor.

DGEJ-ja mund të ndërhyjë në familjen tuaj pas:

- > një kërkesë për ndihmë e bërë nga ana juaj apo nga ana e fëmijës suaj
- > një sinjalizimi nga dikush tjetër, për shembull drejtoria e shkollës apo mjeku i fëmijëve
- > një mase mbrojtjeje të urdhëruar nga drejtësia e paqes, e cila është autoriteti i mbrojtjes së fëmijës (Autorité de protection de l'enfant - APE), apo nga gjykata e rrethit.

Në DGEJ, ndodhen Zyrat rajonale të mbrojtjes së të miturve (Offices régionaux de protection des mineurs - ORPM) të cilat shoqërojnë familjet kur e mira e fëmijës është në rrezik. Ndhmëset shoqërore dhe ndihmësit shoqërorë të DGEJ-së punojnë në bashkëpunim me punonjësit e specializuar në fushën e psikologjisë, pedagogjisë dhe shëndetit. Në kantonin e Vaudit, ka pesë ORPM, në qytetet : Lausanne, Yverdon-les-Bains, Rolle e Montreux (shih detajet e kontaktit në faqen 14).

## Si prindër, ju jeni të parët përgjegjës për të siguruar mbrojtjen e fëmijës suaj

Fëmijët janë më të brishtë se të rriturit, prandaj e drejta i mbron ata në mënyrë të posaçme. Fëmijë quhet një person i moshës 0-18 vjeç. Për fëmijët ka edhe një konventë e cila u kushtohet tërësisht atyre.

Fjala është për Konventën ndërkombëtare lidhur me të drejtat e fëmijës (Convention internationale relative aux droits de l'enfant -CIDE). Kjo Konventë thotë se fëmijët kanë të drejtën për t'u rritur në një mjedis të sigurt dhe të zhvillohen mirë.

### Çfarë duhet ta bëni si prindër

Prindërit mund e duhet t'i rrisin vetë fëmijët e tyre dhe sa më mirë që të jetë e mundur. Ata bëjnë atë që duhet që fëmija të jetë mirë.

Si prindër, ju duhet për shembull:

- > ta mbron fëmijën tuaj
- > të bëni gjithçka që është e nevojshme që ai të zhvillohet mirë, fizikisht e psikologjikisht
- > gjithashtu ju duhet të kërkonit edhe mendimin e fëmijës kur merrni vendime të rëndësishme që kanë të bëjnë me të
- > t'i lini liri fëmijës; kjo liri duhet të përshtatet me moshën e tij

### Çfarë është e mira e fëmijës?

E mira e fëmijës është gjithçka që fëmija duhet të ketë për t'u rritur mirë.

Për shembull:

- > mjaftueshëm për të ngrënë e për të pirë
- > veshje sipas kohës që bën
- > një shtrat dhe një hapësirë të vetën
- > përkujdesje dhe dashuri për të
- > jo dhunë fizike (nuk keni të drejtë ta godisni fëmijën tuaj)
- > jo dhunë psikologjike (për shembull, jo sharje)
- > jo grindje të përsëritura e as dhunë midis prindërve

Nganjëherë e mira e fëmijës është në rrezik e prindërit e tij nuk mundën apo nuk duan ta mbrojnë atë.

Atëherë shteti duhet të bëjë diçka për ta mbrojtur fëmijën.

*Kur një fëmijë është në rrezik në familjen e vet, Shteti duhet të ndërhyjë e ta mbrojë atë*



## Përse DGEJ-ja duhet të ndërhyjë?

DGEJ-ja ndërhyt kur e mira e fëmijës është në rrezik dhe prindërit nuk mund t'i ndryshojnë gjërat të vetëm.

E mira e fëmijës është në rrezik kur ai kërcënohet nga një rrezik fizik a psikologjik. Ka shumë arsye për të cilat e mira e fëmijës mund të jetë në rrezik. Për shembull, kur prindërit:

- > e godasin fëmijën apo i bërtasin rregullisht
- > grinden rregullisht dhe midis tyre ka dhunë
- > janë të ndarë dhe grinden për të ditur se te cili do të shkojë të banojë fëmija
- > kur i ati apo e ëma është i/e sëmurë e nuk mund të kujdeset si duhet për fëmijën

Fëmija vuan nga kjo gjendje. Atëherë ai mund të tregohet agresiv apo të mbyllet në vetvete.

DGEJ-ja ndërhyt sepse prindërit kërkojnë ndihmë.

DGEJ-ja ndërhyt gjithashtu sepse dikush shqetësohet për të mirën e fëmijës dhe e sinjalizon rastin.



## Çfarë është kërkesa për ndihmë?

Ju mund t'i kërkonit ndihmë DGEJ-së, nëse keni vështirësi për t'u kujdesur për fëmijën tuaj dhe si pasojë e mira e tij është në rrezik. Ju duhet t'i drejtoheni Zyrës rajonale të mbrojtjes së të miturve (Office régional de protection des mineurs - ORPM) të vendbanimit tuaj. **Edhe fëmija mund të kërkojë ndihmën e DGEJ-së.**

Cilido që kërkon ndihmë merr kontakt me ORPM-në e rajonit të vet. Ai mund të flasë edhe me një ndihmës shoqëror.

Ndihmësi shoqëror do t'i japë këshilla ose do ta drejtojë në organizma të tjera.

Nëse fëmija ka nevojë për mbrojtje, ndihmësi shoqëror do të propozojë t'ju ndihmojë që ju të mund të kujdeseni më mirë për fëmijën tuaj.

## Çfarë është sinjalizimi?

Nëse prindërit nuk kërkojnë ndihmë dhe e mira e fëmijës është në rrezik, shteti duhet të ndërhyjë. Ligji thotë se i takon Autoritetit të mbrojtjes së fëmijës (Autorité de protection de l'enfant - APE) të ndërhyjë për të mbrojtur fëmijën. Në kantonin e Vaudit, APE-ja është drejtësia e paqes. Nëse prindërit janë duke u divorcuar, gjykata e rrethit mund të shqiptojë masa mbrojtëse.

APE-ja është në dijeni se fëmija është në rrezik, pasi merr një sinjalizim për këtë. Sinjalizim quhet një komunikim me shkrim i cili tregon se ndoshta një fëmijë është në rrezik dhe se prindërit nuk sigurojnë dhënien e një ndihme të mjaftueshme për të.

**Kushdo mund të bëjë një sinjalizim. Për disa specialistë ky detyrim është i shkruar në ligj (për shembull pediatri, psikologu apo drejtori i shkollës).**

Sinjalizimi shkakton çeljen e një procedure pranë autoritetit të mbrojtjes së fëmijës.



## Çfarë bën DGEJ-ja në rast sinjalizimi?

Nëse fëmija juaj është në rrezik, një ndihmës shoqëror i ORPM-së i rajonit tuaj do të diskutojë për rastin e sinjalizuar me ju, si edhe me fëmijën tuaj dhe me specialistët që e njohin fëmijën tuaj (si mësuesi i tij, mjeku i fëmijëve, etj.), me gjasë edhe me të afërmit.


DGEJ-ja do ta shqyrtojë gjendjen për të parë nëse fëmija është në rrezik dhe nëse ai ka nevojë për mbrojtje. Ajo do të japë mendimin e vet. Informacionet përkatëse i kalohen APE-së e cila do të vendosë për vijimin :

- > fëmija nuk është në rrezik, mbyllje e dosjes
- > fëmija është në rrezik dhe një masë mbrojtjeje për fëmijën është e nevojshme

Gjatë procedurës:

- > ju dhe fëmija juaj keni të drejtë të shpreheni para se të merret një vendim
- > ju vetë, avokati juaj apo fëmija juaj keni të drejtë të njiheni me dosjen në çdo kohë
- > ju duhet të bashkëpunoni me DGEJ-në
- > sinjalizuesi njoftohet për ndjekjen e çështjes pas sinjalizimit të bërë prej tij

## Rrugëtimi i sinjalizimit



## Çfarë është një masë mbrojtëse e fëmijës?

Autoriteti i mbrojtjes së fëmijës (Autorité de protection de l'enfant -APE) vendos se si mund të mbrohet e mira e fëmijës. Ai jep vendimin. Ai vendos për marrjen e një mase mbrojtëse të fëmijës për:

- > të mbrojtur dhe ndihmuar fëmijën
- > për të plotësuar formimin e prindërve

APE-ja nuk është atje për dënimin e prindërve. Ajo e shikon me shumë vëmendje atë që prindërit dijnë ta bëjnë mirë dhe atë për të cilën ata kanë nevojë për ndihmë.

APE-ja nuk do t'i bëjë gjërat në vend të prindërve; ajo është atje për t'i shoqëruar, ndihmuar e mbështetur prindërit.

APE-ja do t'i kërkojë DGEJ-së të vejë në jetë dhe të vëzhgojë zbatimin e masës mbrojtëse që ajo ka urdhëruar.



Ligji parashikon shumë masa mbrojtëse.

Në Zvicër, kemi Kodin civil zviceran (Code civil suisse -CC). Këto masa do të kenë një efekt pak a shumë të madh mbi jetën e përditshme të familjes.

**T'u kujtohen prindërve detyrat e tyre** – neni. 307 paragrafi 3 CC

APE-ja mendon se kujtesa e detyrave tuaja si prindër do të mjaftonte për ta mënjanuar rrezikun. Kjo do të mund për shembull t'ju detyrojë të bashkëpunoni me shkollën, të ndiqni një terapi apo të pranoni një ndërmjetësim.

**Vëzhgimi edukativ** – neni. 307 CC

APE-ja mendon se thjesht një kujtesë e detyrave tuaja si prindër nuk mjafton. Ajo i jep atëherë DGEJ-së të drejtën për të parë e për t'u informuar, për të vëzhguar përkujdesjet, edukimin dhe formimin që i jepen fëmijës suaj dhe dhe për këto t'i raportojë APE-së.

**Kujdestaria për ndihmë edukative** – neni. 308 paragrafi 1 CC

APE-ja mendon se një masë më e rëndësishme është e nevojshme për të mbrojtur fëmijën tuaj. Një ndihmës shoqëror i DGEJ-së ju këshillon e ju ndihmon. Ai mund t'ju japë edhe direktiva.

**Kujdestaria për vëzhgimin e marrëdhënieve vetjake** – neni. 308 paragrafi 2 CC

Nëse në kuadrin e një ndarjeje, ju nuk arrini të merreni vesh mbi organizimin e të drejtës së vizitës, APE-ja mund të caktojë një ndihmës shoqëror të DGEJ-së për t'ju ndihmuar në përcaktimin e një kalendari vjetor të vizitave.

**Heqja e së drejtës për të caktuar vendin e banimit** – neni. 310 CC

Kjo masë shqiptohet kur është e pamundur që fëmija juaj të mbrohet me masat e përparshme. APE-ja i jep DGEJ-së mandatin për ta vendosur fëmijën tuaj jashtë vatrës familjare, në të mirën e interesave të tij (për shembull në një konvikt apo në një familje pritëse).

**Heqja e autoritetit prindëror** – neni. 311 e 312 CC

Kjo është masa më fortë e më e rrallë. Ajo shqiptohet kur të gjitha masat e tjera mbrojtëse nuk japin rezultat ose janë të pamjaftueshme. APE-ja cakton një tutor për fëmijën. I takon tashmë Shërbimit të kujdestarive dhe tutelave profesionale (Service des curatelles et tutelles professionnelles -SCTP) të marrë përsipër ndjekjen e fëmijës suaj dhe jo më DGEJ-së.

## Cilat janë të drejtat tuaja dhe ato të fëmijës suaj në kuadrin e një mase mbrojtëse ?

- ✓ E drejta për t'u dëgjuar (për të shprehur pikëpamjen tuaj)
- ✓ E drejta për të pasur qasje në dosjen e fëmijës suaj (si atë të DGEJ-së edhe atë të APE-së)
- ✓ E drejta për të marrë pjesë në procedurë e për të thënë atë që ju mendoni për informacionet e mbledhura nga APE-ja (dëshimtar, ekspertizë)
- ✓ E drejta për t'u informuar për vendimet e mara
- ✓ E drejta për të kundërshtuar kur nuk jeni dakord me vendimin e marë (nga DGEJ-ja apo nga APE-ja)
- ✓ E drejta për të përfituar nga ndihma juridike, nëse dëshironi të ndihmoheni nga një këshilltar juridik (avokat), kur nuk i keni mjetet financiare
- ✓ E drejta për t'u ankuar pranë gjykatës kantonale lidhur me trajtimin e rastit tuaj nga APE-ja
- ✓ E drejta për të kërkuar në çdo kohë pranë APE-së një rivlerësim të gjendjes suaj

*Gjithmonë, është e mira e fëmijës ajo që duhet të jetë në qendër*

# Institucionet që mund t'ju ndihmojnë

## Direction générale de l'enfance et de la jeunesse - DGEJ (Drejtoria e përgjithshme e fëmijërisë dhe rinisë)

Zyra e mbrojtjes së të miturve e vendbanimit tuaj

### Lausanne

Av. des Casernes 2  
Bâtiment administratif de la Pontaise  
1014 Lausanne  
Tel. 021 316 53 10

### Couronne et Gros-de-Vaud

Chemin des Mésanges 3  
Case postale 1000 Lausanne 18  
1032 Romanel-sur-Lausanne  
Tel. 021 388 88 77

### Ouest vaudois

Bâtiment B1, 2e étage, Z.A. La Pièce 16  
Case postale 1046  
1180 Rolle  
Tel. 021 557 53 17

### Est vaudois

Grand'Rue 90  
Case postale 1447  
1820 Montreux  
Tel. 021 557 94 69

### Nord vaudois

Av. Haldimand 39  
1400 Yverdon-les-Bains  
Tel. 024 557 66 00

## Hapësirë dëgjimi

DGEJ-ja ka një Hapësirë dëgjimi për të mbajtur dhe rivendosur marrëdhëniet e besimit midis prindërve dhe DGEJ-së. Hapësira e dëgjimit ka për synim vazhdimin e bashkëpunimit në kushtet më të mira të mundshme.

Ju mund ta bëni kërkesën tuaj për kontakt përmes sitit të internetit

[www.vd.ch/dgej](http://www.vd.ch/dgej)

## Ndihma juridike

Nëse nuk keni mjete të mjaftueshme, ju mund të kërkonti ndihmë juridike pranë autoritetit kompetent lidhur me procedurën e masave mbrojtëse (drejtësia e paqes ose gjykata e rrethit). Formulari në linjë, në sitin e Shtetit të Vaudit, [www.vd.ch](http://www.vd.ch). Ndihma juridike përfshin heqjen e parapagimit të shpenzimeve dhe caktimin e një këshilltari juridik. Ajo nuk është falas, shuma e dhënë duhet të kthehet.

## Zyra e ndërmjetësimit administrativ

Kjo zyrë i ndihmon përdorueset dhe përdoruesit e shërbimeve të saj në marrëdhëniet e tyre me autoritetet dhe administratën dhe vepron si ndërmjetëse në rast konfliktesh.

Adresa: Rue Saint-Martin 6, 1002 Lausanne, [021 557 08 99](tel:0215570899).

## Shërbimi i gatshëm i Urdhërit të avokatëve

Ky shërbim mundëson një konsultim prej 20 minutash me një avokat për një shumë prej CHF 50.-. Katër vende sipas rajonit përkatës. Oraret dhe adresat e sakta duhen parë drejtpërdrejt në sitin [www.oav.ch](http://www.oav.ch).

## KESCHA

Kjo qendër dëgjimi dhe ndihme për fëmijën dhe të rriturin u jep informacione e këshilla personave që kanë të bëjnë me një masë mbrojtjeje të një fëmije apo një të rrituri. Siti i internetit :

[www.kescha.ch](http://www.kescha.ch).





DJES Département de la jeunesse, de  
l'environnement et de la sécurité  
DGEJ Direction générale de  
l'enfance et de la jeunesse

Av. de Longemalle 1  
1020 Renens

Tel. 021 316 53 53

[info.dgej@vd.ch](mailto:info.dgej@vd.ch)

[www.vd.ch/dgej](http://www.vd.ch/dgej)

